



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 362/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga Ymer Hoxha, kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën, e subjektit politik Aleanca Kosova e Re (AKR) me seli në Prishtin, paraqitur kundër subjektit politik Partia Demokratike e Kosovës (PDK) që ka të bëjë me shkeljen e Rregullës Nr.11/2009-Kodit të Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët, në seancën e mbajtur me datë 11.12.2010 mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET ankesa si e pabazuar.

ARSYETIMI

Më 09 Dhjetor 2010, (PZAP) ka pranuar një ankesë nga subjekti politik AKR në të cilën pretendohet se subjekti politik PDK, me të cilën pretendon se me datën 07.12.2010 në rrugën Agim Ramadani (afër Sllovenija sportit) znj. Shpresa Baraliu-Hyseni kandidate për deputete nga rradhët e PDK-së, ka mbuluar me posterat e saj, posterat e kandidatit për deputet nga rradhët e Koalicionit për Kosovën e Re Avdi Smajlaj, duke shkelur në këtë mënyrë Ligjin për Zgjedhjet e Përgjithshme të Kosovës nëni 33 pika (a) dhe Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 nëni 3.1 pika (a).

Parashtruesi i ankesës si provë ka bashkangjitur një fotokopje të fotos pa-ngjyrë si dëshmi nga vendi i ngjarjes.

Ne kuptim të nenit 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe nenit 3.6, pika (c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP parashihet si vijon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

3.6. Te gjitha ankesat duhet te kenë se paku informacionet vijuese: “ c) hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit”.

Duke i shqyrtuar faktet e paraqitura nga pala ankuese, PZAP konsideron se ankesa në fjalë ka mungesë të provave të mjaftueshme dhe të pranueshme për t'u bindur se Shpresa Baliu-Hyseni kandidatë për deputete nga PDK ka mbuluar posterin e kandidatit të AKR-së. Fotokopja e paraqitur si dëshmi mbështetëse për rastin në fjalë, nuk krijon mundësinë për të vërtetuar shkeljen e pretenduar, pasi që nuk dihet identiteti i kandidatit mbi të cilën është i vendosur posteri i kandidatës në fjalë, si dhe nuk shfaq qartë ekzistencën e shkeljes në bazë të Rregullës Zgjedhore “Kodi i Mirësjelljes për Subjektet Politike, Mbështetësit e tyre dhe Kandidatët” NR.11/2009 neni 3.1 pika (a).Për këto arsye, bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

A nr. 362/2010 më datën 11.12.2010.

